



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 5.2.2025

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 19, datë 9.1.2025, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuar si më poshtë vijon:

➤ **DREJTORIA E KONTROLLIT**
SEKTORI I KONTROLLIT TË SKEMAVE KOMBËTARE

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), klasa e pagës IV-3

➤ **Detyrat kryesore:**

1. Siguron marrjen në dorëzim dhe kontrollin fizik të dosjeve për aplikimet e vlerësura fituese nga komisionet e vlerësimit;
2. Kryen verifikime në terren duke krahasuar rezultatet e faktit në terren me ato të aplikimit dhe duke i reflektuar në formularin e verifikimit, bazuar në planet e punës, të miratuara nga drejtori i drejtorisë si dhe programet e përkatëse të punës;
3. Analizon dhe verifikon rezultatet e kontrollit, formularin e verifikimit dhe detyrat e tjera të ngarkuara nga drejtorja;
4. Përgatit raportet e kontrollit në vend brenda afateve sipas masave mbështetëse, pas përfundimit të kontrollit në vend, në zbatim të manualit të procedurave;
5. Dorëzon dosjet së bashku me formularin e verifikimit pranë Agjencisë së Pagesave, në Drejtorinë e përcaktuar sipas Udhëzimit dhe Rregullores së Brendshme;
6. Raporton tek përgjegjësi i sektorit dhe drejtori i drejtorisë mbi kryerjen e detyrave kryesore të përcaktuara;
7. Identifikon dhe raporton parregullsitë/red flag e hasura gjatë procesit të punës në përputhje me manualin e procedurave.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e nivelit “Bachelor” në Arsim i Lartë. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

1. Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
2. Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
3. Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
4. VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 10.2.2025, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL